

DYABIMUJORE
**DHJETOR
2022**



MIRATOHEN DY LIGJE TË REJA PËR BUIQËSINË NË KUVEND

LIGJI I RI

PËR
VRESHTARINË
DHE VERËN

2022



Ligji "Për vreshtarinë dhe verën", një punë e bërë me kujdes të madh për t'i dhënë fuqi dhe vlerë një sektori të rëndësishëm së veçantë për ekonominë familjare të vreshtarëve, kantinave të verës shqiptare dhe objektivit tonë për rritjen e eksporteve.



Ligji për programin IPARD III, i cili hap dritaren më të madhe të financimit për bujqësinë shqiptare. 146 milionë euro për investime në zhvillimin rural, për pesë vitet e ardhshme, me 9 masa financimi, duke parashikuar investime në sektorë që më parë nuk lejoheshin, si ulliri dhe vaj ullirit, përpunimi i peshkut dhe bimët medicinale.

MIRATOHEHET NË KËSHILLIN E MINISTRARVE PROJEKTLIGJI PËR BLETARINË

Bletaria në Shqipëri, për herë të parë, do të ketë një rregullim në nivel ligji, duke i dhënë rëndësi të veçantë, me rregullime gjithëpërfshirëse dhe të detajuara, me qëllim fundor mbrojtjen e popullatës së bletëve, me fokus atë tipike vendase dhe zonave kufitare.

Shqipëria merr pjesë në Konferencën e 171-të të Këshillit të Organizatës Botërore të Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) përmes Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural



Ministria Krifca mbajti fjalën në këtë aktivitet të rëndësishëm ndërkombëtar, ku u diskutua për politikën e ardhshme bujqësore për t'i dhënë zgjidhje sfidave të reja si siguria ushqimore, si pasojë e luftës në Ukrainë, përmbajtjet e shtuara të lidhura me ndryshimet e dukshme klimatike, si dhe domosdoshmëria për politika të përbashkëta në shërbim të rritjes së cilësive së prodhimit.



Zhvillohet takimi me z. Qu Dongyu, Drejtorin e Përgjithshëm të FAO-s, ku u diskutua nxitja e një kalendari më intensiv të projekteve me FAO-në në Shqipëri për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë, shtimin e prezencës së ekspertizës ndërkombëtare në shërbim të politikave tona për rritjen e prodhimeve shqiptare, certifikimit të tyre dhe zgjerimit në tregjet ndërkombëtare.

RRITEN EKSPORTET BUIQËSORE NË VITIN 2022

+15.6%
RRITJE NË SASI

500.75
MILIA S

450.5
MILIA S

2021

2022

Vazhdon rritja e konsoliduar e eksporteve bujqësore në vitin 2022. Në krahasim me vitin 2021, ka një rritje prej 15.6% në sasinë eksportive jashtë vendit. Rritjen më të ndjeshme e ka kapitulli i agroindustrialit, bujqësisë dhe blegtorisë.

HAPIM TREGJIE TË REJA PËR EKSPORTET SHQIPTARE



DËRGOHEN EKSPORTET E PARA SHTAZORE DREJT ARABISË SAUDITE

Një hap më pranë drejt përbushjes së premtimit për hapjen e tregjeve të reja për eksportet bujqësore e blegtorale shqiptare, me qëllim përbushjen e objektivit 1 miliardë dollarë eksporte brenda vitit 2030. Një hap tjetër konkret i kryer nga bujqësia, që vjen si rezultat i një pune të madhe administrative dhe në terren duke vendosur një zinxhir të qartë komande në veterinarin, duke miratuar një paketë higjienike me standarte, duke mbyllur ciklin e kontrollit nga ferma në thetore përmes veterinerëve të dedikuar në çdo thetore dhe treg blegtoral të licencuar.

TAKIME BILATERALE NDËRKOMBËTARE



Romë, Itali - Zhvillohet takimi me Ministrin e Bujqësisë dhe Sovranitetit të Ushqimit, z. Francesco Lollobrigida, mbi zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Italisë në fushën e bujqësisë, sigurisë ushqimore dhe tregtisë.



Paris, Francë - Zhvillohet takimi gjatë pritjes zyrtare në Ministrinë e Bujqësisë dhe Sovranitetit të Ushqimit, me Ministrin Marc Fesneau, ku u diskutua gjerësisht për zgjerimin e bashkëpunimit të Shqipërisë me Francën në blegtori, bujqësi, agropërpunim, veterinarin dhe shërbimet agromjedisore mes dy vendeve tona.



Në Kuvendin e Bujqësisë, Dibrë, Ministria Frida Krifca së bashku me Ministren Belinda Balluku, bashkuan fermerë, blegtorë, bletarë dhe aktorë të tjerë të sektorit, për të dëgjuar njëri-tjetrin dhe për të patur një dialog të vazhdueshëm në ndihmë të zhvillimit të mëtejshëm të bujqësisë shqiptare.



DY ANIJE TË REJA PËR INSPEKTORIATIN E PESHKIMIT SHQIPTAR

Dy mjete lundrimi të sigurisë së lartë u dhuruan nga Bashkimi Evropian, të cilat do t'i ofrojnë mundësinë inspektoriatit të Peshkimit pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të kryejnë një kontroll më efikas të zbatimit të rregullave dhe ligjshmërisë në peshkim.